



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0249

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “Olti Trasing” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit te depos se Barnave dhe ndërtimi i aneksit” me numër të prokurimit 206-24-13446-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 22/05/2025, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e “Olti Trasing” SH.P.K. me nr. 2025/0249, e datës 07/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit te depos se Barnave dhe ndërtimi i aneksit”, me numër të prokurimit 206-24-13446-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Ministria e Shëndetësisë.

2.Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i objektit te depos se Barnave dhe ndërtimi i aneksit”, me numër të prokurimit 206-24-13446-5-1-1.

3.Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.12.2024, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i objektit të depos së Barnave dhe ndërtimi i aneksit” me nr. të prokurimit: 206-24-13446-5-1-1. Me datën 31.01.2025, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,793,000.03 €

Me datën 19.03.2025 AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

OE “Olti Trasing” SH.P.K. me datën 24.03.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 28.03.2025, AK - Ministria e Shëndetësisë me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Olti Trasing” SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2025/0249, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 30.01.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Olti Trasing” SH.P.K

Pretendimi i parë (I): Konsiderojmë se nuk është i bazuar pretendimi juaj i parë ankimor, meqenëse Kriteret për Dhënien e Kontratës kanë qene mjaft të qarta dhe ne si AK i kemi respektuar ato dhe kemi vepruar sipas peshimit të nën kriterëve të përcaktuara në NJK dhe DT: Shikoje nën kriterin e dytë, të dy ofertat e keni përshkrimin si e ka hartuar AK: Kryerja e punëve (min. 6 muaj - max. 24 muaj). Gjate përgatitjes së aktivitetit në e prokurim e kemi kufizuar minimumin 6 muaj dhe maksimumin 24 muaj për kryerjen e punëve. OE i rekomanduar e ka ofruar afatin 6 muaj, andaj nuk ka arsye që të kontestohet kjo gjë, andaj në këtë aspekt ne si AK jemi plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ju e keni ofruar afatin për kryerjen e punëve 20 muaj (600 dite), ndërkohe që OE i rekomanduar e ka ofruar 6 muaj (180 ditë) të dy ofertat jeni brenda limiteve të përcaktuara 6-24 andaj asnjërit nuk mund të u kontestohet afati, por pikërisht afati për kryerjen e punëve si nën kriter e ka bërë dallimin në konkurrencë. Interesi i AK është që sa më parë të renovohet ky objekt dhe sa më parë të arrijmë të vendosim barnat e Listës Esenciale në hapësirat e akomoduar me standarde të kërkuara, meqenëse aktualisht depoja e improvizuar e MSh-së në bodrumin - ish garazhet e Rilindjes në të cilën ruhen barnat dhe materiali shpenzues medicinal është në gjendje jo të mirë dhe si i tillë nuk i plotëson kushtet e duhura andaj afati për realizimin e punëve është aspekt shumë i rëndësishëm për MSh si investitor. Gjate përgatitjes së tenderit si dhe gjate vlerësimit të ofertave, ne si AK kemi vlerësuar se afati minimal prej 180 ditësh (6 muaj) është brenda mundësive inxhinierike për realizimin e një projekti të tillë, por kuptohet këtë afat mund ta arrijnë kompanitë me kapacitete dhe eksperience me të lartë në ekzekutim të punëve, ndërsa nuk mund ta arrijnë kompanitë që nuk kanë kapacitete ose që nuk shquhen për eksperience në punë profesionale dhe kualitative. Gjithashtu konsiderojmë se janë të pa nevojshme shtjellimet tjera rreth peshës 20% të kriterit për kryerjen e punëve, meqenëse këto është dashtë të kontestohen në fazën e tenderimit, në afatet e parapara në DT për sqarime shtese, e të cilin nën kriter ju nuk e keni kontestuar në fazën e sqarimeve shtese kur ka mund të shqyrtohet, por po e kontestoni tani vetëm si alibi meqenëse nuk jeni shpallur fitues.

Pretendimi i dytë (II): Konsiderojmë se nuk është i bazuar pretendimi juaj i dytë ankimor, meqenëse OE i rekomanduar i ka plotësuar të gjitha kërkesat e NJK dhe DT. Nuk qëndron pretendimi për ta kontestuar Deklaratën e Mbështetjes bankare të OE të rekomanduar, meqenëse OE i rekomanduar e ka tejkaluar kërkesën e AK, ne kemi kërkuar mbështetje 500,000 euro ndërsa OE e ka ofruar deri 1.2 milion euro mbështetje si dhe 300,000 euro mbitërheqje. Deklarata e Mbështetjes bankare të OE të rekomanduar është shumë me bindëse për AK se sa deklarata e ofruar nga ana juaj për të njëjtën kërkesë, meqenëse të letër përkrahja juaj në paragrafin e fundit Banka NLB e konfirmon mbështetjen prej 500,000 euro (saktë sa vlera e kërkuar), ndërsa të letër përkrahja e OE Termomontimi në paragrafin e fundit e njëjta Banke NLB e konfirmon mbështetjen prej 1,500,000 euro (trefishin e vlerës së kërkuar).

Pretendimi juaj në lidhje me mos ofrimin e qasjes nuk qëndron, meqenëse ne u kemi ofruar tërë dokumentacionin e ofertës, përveç Deklaratave tatimore 2020-2023 ku e kemi potencuar se nuk mund të ua përcjellim për shkak të Kërkesës për Sekret Afarist. Si mund të pretendoni për kufizim të qasjes në dokumentacion kur edhe ju vetë si OE e keni ofruar të njëjtën Kërkesë për Sekret Afarist konform Aneksit 3 të DT dhe me të njëjtat kufizime sikur OE i rekomanduar.

Pretendimet ankimore të Ankuesit “Olti Trasing” SH.P.K

Pretendimi ankimor (I) - Shkelje e nenit 1 dhe nenit 6 të LPP, Konsiderojmë së Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe shpërblimit me kontrate të OE: Termomontimi SH.P.K i cili ka dorëzuar ofertën me çmimin me të larte nga dhjete ofertat e pranuar për këtë aktivitet të prokurimit, ka bere shkelje substanciale të nenit 1 të LPP që është qëllimi i ligjit, nenit 6 të LPP- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti për faktin së nuk kane arritur: Të parandaloj keqpërdorimin nga ana OE:Termomontimi Sh.P.K të nen kriterit të vlerësimit të afatit 180 dite (afat i parealizueshëm dhe spekulues) për kryerjen e punëve. Arsyeja së pse ne konsiderojmë kështu janë: Së pari Autoriteti Kontraktues në Aneksin 7 - kriteret për dhënien e kontratës të nen kriteri, 2- Kryerja e punëve nuk e ka shënuar afat minimal dhe maksimal të kryerjes së punëve ashtu siç e ka shënuar të nen kriteri, 3- Gradacioni i punimeve (nga 1 deri 10 vite), por vetëm në Dosje të Tenderit të FDT të neni 5.2 ka shënuar: Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: ne muaj 24 dhe në Njoftimin për Kontrate të neni II.3) kohëzgjatja e kontratës apo afatet kohore për përfundim, ka shënuar: Kohëzgjatja në muaj.

Së dyti Autoriteti Kontraktues në Dosje të Tenderit të FDT të neni 14.2 ka shënuar: Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës se kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj, të Kushtet c Veçanta të Kontratës të neni 10.1 ka shënuar: Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % të vlerës totale të kontratës me vlefshmëri prej 25 muaj dhe në Njoftimi për Kontrate të neni III. 1.1 ka shënuar: Vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10% e vlerës se kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj.

Së treti Autoriteti Kontraktues e ka mbivlerësuar nen kriterin e vlerësimit të afatit të kryerjes së punëve me 20 % të pikëve për faktin së sipas nenit Neni 71A - (Dëmet e likuiduara (Penalltitë) gjatë zbatimit të kontratës) të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi (d) e përcakton se nëse mosrealizimi i punëve kufizon përdorimin e zakonshëm të ndërtimit të kontraktuar, vlera e penalltive do të përcaktohet në KVK, me normë ditore për vlerën totale të kontratës për çdo ditë të vonesës, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Së katërti AK të Kushtet e Veçanta të Kontratës të neni 19.1 të këtij aktiviteti të prokurimit ka shënuar: “Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës”. Së pesti, bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2025- Tabelat e Projekteve Kapitale të Ministrisë së Shëndetësisë, kodi 19380 - Renovimi i Depos, faqe 46/113 shihet së buxheti për këtë projekt është i ndare për vitet 2025,2026,2027. Bazuar në të gjitha këto të dhëna që shënuam me larte shume mire shihet së shpërblimi me kontrate të një Operatori Ekonomik që ka ofertën me çmimin me të larte nga të gjitha dhjete ofertat e pranuar nga AK në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka çmimin për 290,554.42 € me të larte së të ofertës së kompanisë tone, Olti Trasing SH.P.K dhe që keqpërdore lëshimet që Autoriteti Kontraktues ka bere gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit duke ofertuar me afat të pa realizueshëm - vetëm 180 dite të kryerjes së punëve vetëm sa për ta fituar kontratën, është në kundërshtim të plote me nenin 1 dhe nenin 6 të LPP. Ketë e dëshmon edhe fakti së OE: Termomontimi SH.P.K edhe nëse vonohet në realizimin e kryerjes se punëve Autoriteti Kontraktues mund ta ndëshkoje vetëm për 40 dite vonese në vlere prej 177,055.44 € (1,770,554.42 X 10%). Krahasuar me çmimin e ofertës tone prape buxheti i Ministrisë se Shëndetësisë dhe qytetareve të Republikës së Kosovës do të dëmtohet 113,498.98 € (290,554.42 €- 177,055.44 €).

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë në Vendimin për Refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim teton ti shtrembëroj faktet duke shënuar: “Kriteret për Dhënie të Kontratës kane qenë mjaft te qarta dhe ne si AK i kemi respektuar ato dhe kemi vepruar sipas peshimit të nen kritereve të përcaktuara në NJK dhe DT”. E vërteta është se AK- Ministria e Shëndetësisë as në Njoftimin për Kontrate dhe as në Dosjen e Tenderit në asnjë vend nuk ka shënuar - përcaktuar afatin e kryerjes së punëve: min 6 muaj -max 24 muaj. Në konsiderojmë se mos vendosja nga AK e kësaj informate kaq të rëndësishme në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit ka qenë e qëllimshme për ta favorizuar OE që AK ka shpërblyer me kontrate. Këtë e dëshmon fakti se është i vetmi OE që ka ofertuar me afat të kryerjes së punëve prej 180 dite- 6 muaj (afatin minimal) që dhe ka ofertuar më çmimin më të lartë nga dhjetë ofertat e pranuar nga AK për këtë aktivitet të prokurimit. Këto veprime të AK dhe oferta e OE të rekomanduar për kontrate na bënë të dyshojmë se OE i rekomanduar për kontrate ka qenë i vetmi OE që ka pasur informatën për afatin minimal të kryerjes së punëve para se të ofertoj. Gjithashtu AK - Ministria e Shëndetësisë në Vendimin për Refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim tenton ti shtrembëroj faktet duke ju referuar Formularit të Tenderit ku janë të shënuara afatet e kryerjes së punëve në ofertën e kompanisë tone dhe OE të rekomanduar për kontrate. Formularin e Tenderit e gjeneron sistemi i E-Prokurimit dhe i njëjti pa bërë asnjë ndryshim ngarkohet prapë në sistemin e Prokurimit.

AK - Ministria e Shëndetësisë në Vendimin për Refuzim të Kërkesës tone për Rishqyrtim vetë e dëshmon shkeljen që ka bërë me mos publikimin e afatit minimal dhe maksimal të kryerjes së punëve në NJK dhe DT dhe favorizimin e OE të rekomanduar për kontrate, ku shënon: “Gjate përgatitjes së aktivitetit të prokurimit e kemi kufizuar minimumin 6 muaj dhe maksimumin 24 muaj për kryerjen e punëve. OE i rekomanduar e ka ofruar afatin 6 muaj, andaj nuk ka asnjë arsye që të kontestohet kjo gjë, andaj në këtë aspekt ne si AK jemi plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”. Ky konstatim i AK nuk qëndron për faktin se AK, afatin minimal 6 muaj dhe maksimal 24 muaj për kryerjen e punëve nuk e ka shënuar në asnjë dokumente të publikuar në Platformën e E- prokurimit para se të ofertohej prandaj konsiderojmë se kufizimi i këtij afati vetëm në sistemin e prokurimit pa pasur mundësi që të gjithë OE të kenë pasur mundësi ta kenë informatën për afatin minimal dhe maksimal të kryerjes së punëve është shkelje substanciale e legjislacionit të prokurimit publik.

Konstatimi i AK se “Interesi i AK është që sa më parë të rinovohet ky objekt konsiderojmë se është i pa qëndrueshëm për faktin se sikur AK të kishte interesin që sa më parë të rinovohet ky objekt, nuk do të lente tolerancën kaq të madhe të afatit minimal 6 muaj dhe maksimal 24 muaj që shprehur në përqindje ndryshimi është 400 % apo 1 me 4.

Konstatimi i AK se “Gjate përgatitjes së tenderit si dhe gjate vlerësimit të ofertave , ne si AK kemi vlerësuar se afati minimal prej 180 ditësh (6 muaj) është afat brenda mundësive inxhinierike për realizimin e një projekti të tillë” , atëherë shtrohet pyetja se cila ka qenë arsyeja që AK ka përdorë tenderin Ekonomikisht më të Favorshëm. Për çfarë ekonomiciteti kemi të bëjmë tani gjate vlerësimit me vendimin që ka marrë ka dëmtuar buxhetin e qytetareve të Republikës së Kosovës për 290,554.42 €.

Konstatimi i AK “pesha 20 % të kriterit të kryerjes së punëve , është dashtë të kontestohet në fazën e tenderimit në afatet përpara në DT për sqarime shtese është e pa qëndrueshme për faktin se ne si OE dhe besojmë që edhe shumica e OE nuk kemi pasur asnjë informate që AK ka caktuar afatin e kryerjes së punëve: min 6 muaj -max 24 muaj.

Pretendimi ankimor (II) - Shkelje e nenit 59 të LPP dhe nenit 40 të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik. Siç e kemi cekur dhe me larte pas kërimit të qasjes në dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues nuk na ka lejuar qasje të plote me arsyetimin së OE: Termomontimi SH.P.K së bashku me ofertën ka dorëzuar Aneksin 3- Kërkese për Sekret Afarist. Megjithatë bazuar në Kërkesat e shumta të cilat i ka kërkuar Autoriteti Kontraktues në Dosje të Tenderit dhe Njoftimin për Kontrate të Kapacitetet Ekonomike dhe Financiare dhe Kapacitetet Teknike dhe Profesionale, dhe duke u bazuar në ofertat që OE: Termomontimi SH.P.K ka dorëzuar në aktivitetet tjera të prokurimit konsiderojmë së Oferta e këtij OE nuk i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues- Ministria e Shëndetësisë. Konkretisht konsiderojmë së Deklarata nga banka që dëshmon së OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 500 mijë Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit). Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar, si kredi e pakushtëzuar në emër të projektit që ka dorëzuar OE: Termomontimi SH.P.K së bashku me ofertën nuk është konforme kërkesës së AK-kredi e pakushtëzuar në emër të projektit.

Gjithashtu Konsiderojmë së OE: Termomontimi SH.P.K nuk e ka plotësuar Kërkesën 4 të Kapaciteteve Teknike dhe Profesionale që ka të beje me mjetet për realizimin e kontratës dhe dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira). Konstatimi i AK në vendimin për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim se “ Deklarata mbështetëse bankare të OE të rekomanduar është shumë bindëse për AK sa deklarata e ofruar nga ana e juaj për të njëjtën kërkesë , meqenëse të letër përkrahja juaj në paragrafin e fundit Banka NLB e konfirmon mbështetjen 500,000 (saktë në vlerën e kërkuar , ndërsa të letër përkrahja e OE Termomontimi në paragrafin e fundit e njëjta Banka NLB e konfirmon mbështetjen prej 1,500.000 euro tre fish të vlerës së kërkuar” nuk qëndron për faktin se në letër përkrahjen që ne kemi dorëzuar së bashku me ofertën në paragrafin e fundit shënon: “Nëse kompania Olti Trasing SII.P.K shpërblehet me kontrate nga Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë për kontratën me titull: Renovimi i objektit të depos së Barnave dhe ndërtimi i aneksit dhe numër të prokurimit: 206-24-13446-5-1-1, NLB Banka sh.a do ta mbështesë financiarisht në shumën deri në 500,000.00 € (pesëqind mijë euro).

Ndërsa në Deklaratën që ka dorëzuar Termomontimi sigurisht si zakonisht shënon se “ Ka qasje në kredi deri në vlerën 1,500.000 E “ pa specifikuar emrin e AK dhe emrin dhe numrin e projektit ashtu siç shënon në deklaratën tone. Qasjen në kredi që e ka Termomontimi mund ta ketë shfrytëzuar dhe të shfrytëzojë edhe para nënshkrimit të kontratës me ju si AK për projekte tjera , investime kapitale , etj, por jo të dedikuara për këtë projekt në të cilin ka ofertuar. Bazuar në të gjitha këto që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP -së, që Ankesën tone ta konsiderojë si të bazuar dhe lenden ta kthejë në Ri-vlerësim

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11/04/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0249/2025, i cili është dorëzuar me datë 25/04/2025.

Lidhur me pretendimet e OE "Olti Trasing" SH.P.K ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/0249 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitë e nenit 59 te LPP-se dhe njeherit pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate. Pas përfundimit te vlerësimit te ofertave AK-Ministria e Shëndetësisë, e njofton OE ankues lidhur me rezultatet e vlerësimit te ofertës përmes te cilës OE ankues njoftohet si tenderues i pasuksesshëm. Eksperti shqyrtues, sqaron se për aktivitetin e prokurimit me titull: Renovimi i objektit te depos se barnave dhe ndërtimi i aneksit, autoriteti kontraktues si kriter për dhënie te kontratës e ka përdorur: Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm. Pas përfundimit te vlerësimit te ofertave, autoriteti kontraktues, sipas peshës se vendosur për nen kriteret i ka ranguar ofertat si ne tabelën e mësipërme:

- OE Termomontimi – i rekomanduar 88.51
- OE BM Group 86.60
- OE Olti Trasing – ankues 86.00.

OE ankues ne ankesën e tij, pretendon se AK-MSH e ka favorizuar OE te rekomanduar për kontrate te nën kriteri i afateve për realizimin e projektit, ku edhe është bere dallimi ne pikë. OE ankues ka marr 6.00 pikë - (afati për implementimin e projektit 600 dite ose 20 muaj) ndërsa, i rekomanduari për kontrate ka marr 20.00 pikë - (afati për implementimin e projektit 180 dite).

Oferta e OE ankues:

1,480,000.00 EUR			
Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]			
Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të			
Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi	0.70	1,480,000.00
2	Kryerja e puneve (min. 6 muaj - max. 24 muaj)	0.20	20 muaj
3	Garancioni i punimeve (nga 1 deri 10 vite)	0.10	10 vite

Oferta e te rekomanduarit për kontrate:

1,770,554.42 EUR			
Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]			
Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të			
Nr.	Nën-kriteri	Koeficient	Përgjigje EO
1	Çmimi	0.70	1,770,554.42
2	Kryerja e puneve (min. 6 muaj - max. 24 muaj)	0.20	180 Dite (6 Muaj)
3	Garancioni i punimeve (nga 1 deri 10 vite)	0.10	10 Vite

Eksperti shqyrtues, duk u bazuar ne pretendimin e OE ankues, ku pretendon se AK-MSH e ka favorizuar OE te rekomanduar për kontrate me arsyetimin se është i vetmi operator ekonomik qe ka ofertuar me minimum 6 muaj dhe njeherit pretendon se autoriteti kontraktues ne asnjë pike te dosjes se tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nuk e ka cekur afatin min. 6 muaj – 24 muaj.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues për arsye se siç është sqaruar edhe me larte, ku eksperti shqyrtues ka prezantuar edhe ofertat e dy operatoreve ekonomik, ku rezulton se edhe OE ankues ka qene i njoftuar me minimumin dhe maximumin e afatit për kryerjen e punëve.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne tabelat e me sipërme te te dy operatoreve ekonomik, vlerëson se nuk mund te konsiderohet favorizim përderisa te dy OE-te kanë qene te njoftuar dhe se OE ankues e ka plotësuar te njëjtën tabelë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ne ankesën e tij te deponuar ne OSHP, nuk e ka atakuar ofertën e OE ankues e dyte me radhë (OE BM Group), me te cilën eksperti shqyrtues vlerësoj se me rastin e parashtrimit te ankesës OE ankues nuk ka arritur te dëshmojë se është pale me interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, sepse edhe po te kthehej ne rivlerësim aktiviteti i prokurimit, është oferta e OE BM Group e cila është ne radhë, ofertë te cilën nuk e ka atakuar OE ankues.

OE ankues pretendon se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 10 te LPP-se, me arsyetimin se nuk ka ofruar qasje ne dokumentet e OE te rekomanduar për kontrate sepse sipas AK-se i njëjti e ka dorëzuar kërkesën për sekret afarist.

Pavarësisht qasjes se kufizuar, OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën qe operatori ekonomik te dëshmojë se ka mjete te gatshme ose qasje te pakushtëzuar ne kredi për realizimin e kontratës ne vlere se paku 500,000.00 euro.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontrate e ka ofruar dëshminë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe vlere e prezantuar ne dëshminë e bankës është deri ne 1,500,00.00 euro. Poashtu lidhur me këtë dëshmi OE ankues pretendon se dëshmia e te rekomanduarit për kontrate nuk e ka te shënuar titullin e projektit, numrin e projektit, emrin e AK-se, lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim sepse dëshmia e lëshuar nga banka i ka te gjitha te dhënat për te cilat OE ankues pretendon se nuk janë.

OE ankues pretendon se, OE i rekomanduar për kontrate, nuk i ka ofruar dëshmi për kërkesën e DT-se, nr: 4, qe ka te beje me mjetet për realizimin e kontratës dhe dëshmitë e pronësisë (apo te marrjes me qira).

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontrate, ne ofertën e tij, i ka dorëzuar te gjitha dëshmitë lidhur me pajisjet për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve me disa operatore ekonomik. Prandaj nuk qëndron ky pretendim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërsaq operatori ekonomik nuk është pajtuar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i caktuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha

pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e Ankuesit (me të dhëna si në shkresat e lëndës) janë të pabazuara pasi që sipas konstatimeve të ekspertit shqyrtues nuk qëndron pretendimi ankimor se AK-MSH e ka favorizuar OE te rekomanduar për kontrate me arsyetimin se është i vetmi operator ekonomik qe ka ofertuar me minimum 6 muaj, sepse nga verifikimi i dokumentacionit dhe ofertat e te dy OE-ve (Ankuesit dhe OE te rekomanduar) rezulton se edhe OE ankues ka qene i njoftuar me minimumin dhe maximumin e afatit për kryerjen e punëve, andaj ky pretendim i tij ankimor, nuk qëndron.

Paneli shqyrtues, sipas bindjes se tij te pavarur gjithmonë duke u mbështetur ne ekspertizën e ekspertit shqyrtues , konstaton se nuk qëndron edhe pretendimi ankimor se OE i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën qe operatori ekonomik te dëshmojë se ka mjete te gatshme ose qasje te pakushtëzuar ne kredi për realizimin e kontratës ne vlere se paku 500,000.00 eurosepse OE i rekomanduar për kontrate e ka ofruar dëshminë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe vlere e prezantuar ne dëshminë e bankës është deri ne 1,500,00.00 euro, dëshmi kjo e lëshuar nga banka me të gjitha te dhënat për te cilat OE ankues pretendon se nuk janë.

Paneli shqyrtues e konsideron si të pabazuar pretendimin e Ankuesit (me te dhëna si me larte) se OE i rekomanduar për kontrate, nuk i ka ofruar dëshmi për kërkesën e DT-se nr. 4. qe ka te beje me mjetet për realizimin e kontratës dhe dëshmitë e pronësisë (apo te marrjes me qira), sepse ne ofertën e tij, janë dorëzuar te gjitha dëshmitë lidhur me pajisjet për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve me disa operatore ekonomik.

Rrjedhimishtë, Paneli Shqyrtues ankesën e OE ankues e kualifikohet si pjesërishtë të bazuar vetëm për faktin se AK-ja nuk ka vepruar në plotni me nenin 10 të LPP, sa i përket ofrimit të qasjes së OE ankues. Ngase, ka qenë dashtë që qasja të ofrohet me version të pastruar, konform nenit 10, paragrafit 3 të LPP. Por që konsideroj se kjo është e pamjaftueshme që lëndën ta kthej në ri-vlerësim pasi që OE i rekomanduar rezulton si i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

-Përfundim-

Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë përpilimit të dosjes së tenderit duhet të ketë kujdes që të mos hartojë kritere diskriminuese të cilat bien ndesh me parimet e prokurimit publik, andaj paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 104, paragrafi 4, 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore, për të dy ankuesit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Olti Trasing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: